• Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore : • Shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve të administratës vendore. • Shpërblimi i kryetarëve të fshatit të njësive administrative në formën e shpërblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi.	
iii. Aktivitetet kryesore të projektit	
Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën vendore dhe shpërblimi i kryetarëve të fshatit të njësive administrative kryhet në formën e shpërblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi.	
b) Rezultatet që prisni	
Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë dhe shpërblimi honorareve i kryetarëve të fshatit të Njësive Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër	
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
1. Drejtoria e Financës 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 3. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia e Shkodrës
e) Shpenzimet e llogaritura	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	168,572	168,572				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	26,811		26,811			
A.3	Shpërblim për dalje në pension						
A.4	Shpërblim Kryetar fshati (92 kryetarë fshati)	32,016			32,016		
	Shuma	227,399	168,572	26,811	32,016		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	168,572	168,572				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	26,811		26,811			
A.3	Shpërblim për dalje në pension						
A.4	Shpërblim Kryetar fshati (92 kryetarë fshati)	32,016			32,016		
	Shuma	227,399	168,572	26,811	32,016		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale

A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	168,571	168,571				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	26,811		26,811			
A.3	Shpërblim për dalje në pension						
A.4	Shpërblim Kryetar fshati (92 kryetarë fshati)	32,016			32,016		
	Shuma	227,398	168,571	26,811	32,016		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2026, 2027, 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Financës Administratorët e NJA Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.2	PAA141.Q1.O1.A2. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Riorganizimi në institucionin e Bashkisë Shkodër vendosi një koncept të ri në menaxhimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë rëndësi parësore kapitalit njerëzor dhe investimeve në ndërtimin e kapaciteteve duke e konsideruar element thelbësor strategjik në përmbushjen e objektivave afatgjata të institucionit. Rishikimi i organizimit të veprimtarisë së Bashkisë Shkodër ishte domosdoshmëri për t'iu përgjitur me intensitet nevojave të qytetarëve në qytet dhe në zonat rurale. Bashkia Shkodër ndërmori disa hapa të rëndësishëm për forcimin e stafit dhe infrastrukturës bashkiake dhe për vënien efiçente të stafit në punë si edhe ofrimin e kushteve më dinjitoze të punës .U krijua Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e mirëmbajtjes së objekteve publike me qëllim intensifikimin e punës së mirëmbajtjes së mjediseve publike, rrugëve, trotuareve e gjelbërimit, mirëmbajtjes së shkollave, kopshteve e godinave të tjera publike, përmirësimi i sinjalistikës horizontale e vertikale, ndërtimi i rrjetit të bicikletave në të gjithë qytetin etj. të pasur një administratë me performancë të lartë, cilësi më të mirë në ofrim shërbimesh publike vendore ndaj komunitetit si dhe mirë administrim dhe menaxhim të financave e të ardhurave të saj vendore nëpërmjet: Rritjes së cilësisë dhe e sigurisë në funksion të shërbimit ndaj banorëve të Bashkisë dhe Njësi Administrative; Reduktimit të kostos me anë të menaxhimit efikas dhe kualifikimit të burimeve njerëzore për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera publike vendore; Rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe ekonomike duke mundësuar ofrimin e një shërbimi gjithëpërfshirës dhe më të shpejtë në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër; Efekshmërisë në zgjidhjen më të shpejtë të problematikave dhe situatave emergjente që mund të krijohen; Përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet administrimit më të mirë të kapaciteteve teknike të bashkisë dhe të tretëve si dhe një sistem monitorimi të mirë organizuar duke krijuar një standard të njëjtë, të administrimit më të mirë të burimeve njerëzore duke shmangur dublimin e shumë pozicioneve të punës sa i përket funksioneve që lidhen me mirëmbajtjen e godinave dhe aseteve publike të Bashkisë Shkodër. Rekrutimi me staf të kualifikuar për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune u realizua me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë u realizua përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242 datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar , VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"i ndryshuar. Sipas ligjit konkurimi ndjek disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të këtij komisioni, nga të cilët disa prej tyre ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar paguhen në vlerën 10.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Anëtarët e KPLP dhe KPND, paguhen në vlerën 5.000 lekë për çdo procedurë konkurimi. Këto shpenzime përballohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër bazuar në planin vjetor të nevojës për rekrutime.		
ii. Synimi i projektit		
- Vazhdim i përmirësimit të qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore. - Rekrutimi i Administratës Vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në kohë, në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve në fuqi duke garantuar plotësimin e standarteve në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar dhe në bazë të planit vjetor të rekrutimeve .		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
• Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë (sipas VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil" njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit. • Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune) • Hartimi i dokumentacionit përkatës • Ngritja e Komisioneve të Pranimit sipas rasteve • Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër • Zhvillimi i procedurave të testimit. • Emërimet		
b) Rezultatet e pritshme		
Në zbatim të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar , Njësia e Burimeve Njerëzore përgatit planin vjetor të pranimeve për vitin pasardhës. Ky planifikimin vjetor për pranimin në shërbimin civil, përfshin: • Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil; • Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil; • Ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në pikën "1" dhe "2".		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër			Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse					
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.		200			200		
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)							
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës							
A.4	Ngritja e Komisioneve te Pranimit sipas rasteve							
A.5	Publikimi në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër							
A.6	Zhvillimi i procedurave te testimit							
A.7	Emërimet							
	Shuma		200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike tëinstitucionit.		200			200		
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet ekperiencë pune)							
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës							
A.4	Ngritja e Komisioneve te Pranimit sipas rasteve							
A.5	Publikimi në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, nëstendate informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër							
A.6	Zhvillimi i procedurave te testimit							
A.7	Emërimet							
	Shuma		200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale

A.1	Hartimi i planit vjetor për rekrutim, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë njësitë e qeverisjes vendore publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.					
A.2	Përcaktimi i shpenzimeve për pagesën e ekspertëve të jashtëm në lidhje me procedurat (ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara, me mbi 5 vjet eksperiencë pune)	200			200	
A.3	Hartimi i dokumentacionit përkatës					
A.4	Ngritja e Komisioneve të Pranimi sipas rasteve					
A.5	Publikimi në Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në stendat e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër					
A.6	Zhvillimi i procedurave të testimit					
A.7	Emërimet					
	Shuma	200			200	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2026, 2027, 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 3	PAA141.Q1.O1.A3 Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Me vendimin nr.5 datë 20.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës për Autonominë Vendore u bë ndryshimi i emrit nga "Shoqata për Autonominë Vendore" në "Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë", ndryshimi i Logos dhe Selisë së Shoqatës, shfuqizimi i Statutit dhe rregullores së vjetër të Shoqatës, miratimi i dhe hyrja në fuqi i Statutit dhe Rregullores së re. Në këtë Shoqatë aderohet edhe Bashkia Shkodër. Kjo Shoqatë është një shoqatë jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Shoqata është një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive dhe mban statusin e një organizate jofitimprurëse (OJF) me një shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit. Përpjekjet e saj të vazhdueshme kanë synuar sensibilizimin e strukturave dhe institucioneve të pushtetit qendror për përshtetimin e procesit të decentralizimit, si dhe konsolidimin e rolit të bashkive në ushtrim të rolit të tyre qeverisës, duke dhënë në vazhdimësi rezultate konkrete. Roli dhe kontributi i shoqatës sot është mjaft i vlerësuar dhe i njohur jo vetëm nga anëtarët e saj por edhe nga institucionet në pushtetin qendror, donatorët, shoqatat ndërkombëtare të autoriteteve vendore. Qëllimi i saj është që të lehtësojë vendosjen e kontakteve ndërmjet Bashkive brenda vendit dhe partnerëve të tyre jashtë vendit, si shoqata simotra e institucioneve ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, eksperiencave dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit. Anëtarë e Shoqatës, mund të jetë çdo bashki e RSh, e cila pranon statutin e shoqatës, angazhohet të punojë për realizimin e misionit dhe qëllimeve të shoqatës, si dhe të paguajë kuotën e anëtarësisë sipas kushteve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme për pagesën e kuotizacionit vjetor.						
ii. Synimi i projektit						
Mbrojtja e interesave të përbashkëta të Bashkive me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore dhe garantimi i pagesës së kuotizacionit vjetor nga buxheti i bashkisë.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Realizimi i pagesës së kuotizacionit vjetor për Shoqatën e autonomisë vendore						
b) Rezultatet që prisni						
Vendosjen e kontakteve ndërmjet Bashkive brenda vendit dhe partnerëve të tyre jashtë vendit, si shoqatasimotra e institucioneve ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, eksperiencave dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Financës				Bashkia e Shkodrës		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Pagesë kuotizacioni Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë	2,557	Paga	Sigurime	Operative	Transferime 2,557
	Shuma	2,557				2,557
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Pagesë kuotizacioni Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime 500
	Shuma	500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Pagesë kuotizacioni Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime 500
	Shuma	500				500
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 – Dhjetor 2028			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 4	PAA141.Q1.O1.A4 Kuota e Akademisë së Pushtetit Vendor	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.									
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:											
i. Situata											
Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), në mënyrë që ato të ushtrojnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efikasitet dhe në përputhje me strategjitë e zhvillimit kombëtar. Ky ligj kërkon qartë trajnim sistematik dhe të buxhetuar të trupës legjislativë dhe ekzekutive të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak, për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe efikase, ndërkohë financimi i trajnimeve dhe kualifikimeve do të bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi (Neni 51/4). Kushtet e shërbimit të punonjësve të NJVV-ve duhet të jenë të tilla që të lejojnë rekrutimin e personelit të cilësisë së lartë, në baza të meritave dhe kompetencave, dhe për këtë qëllim ata gëzojnë të drejtën për të marrë trajnime përmes NJVV-ve, pasi trajnimi si shërbim thelbësor i çdo politike për burimet njerëzore, u mundëson punonjësve përditësimin e diturive dhe aftësive të tyre. Trajnimi është një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u siguruar që të zgjedhurit vendorë do t'i kryejnë detyrat e tyre me efikasitet. Duke qenë se këshillat vendorë ndryshojë vazhdimisht mbas cdo mandati, NJVV-të pritet që t'i ofrojnë përfaqësuesve të zgjedhur, posaçërisht këshilltarëve të zgjedhur rishitas, programe trajnuese për rolin, detyrat dhe kufizimet e politikave të zgjedhur. Programe të tilla pritet që të ofrojnë njohuri për çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e autoriteteve vendore si financat, transparenca, të qenit të hapur, kodi i etikës, konflikti i interesit, konsultimi publik dhe llogaridhënia. Nisur nga sa më sipër pritet që në vitin 2026 NJVV-të dhe Qeveria Qendrore të mbështesin në mënyrë më të qëndrueshme trajnimet e detyrueshme, zhvillimit profesional dhe platformave për shkëmbimin e njohurive mes stafeve dhe të zgjedhurve vendorë, për të rritur performancën e qeverisjes vendore. Në funksion të këtij objekti, bazuar dhe në nevojat specifike të NJVV-ve për ofrimin me cilësi të 41 shërbimeve bashkiake për qytetarët dhe bizneset, Qeveria Qendrore në bashkëpunim me NJVV-të kanë ndërmarrë iniciativën për ngritjen e një Qendre (Akademie) për Trajnimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore të NJVV-ve, e cila do të mbështetet financiarisht dhe do të ketë vendimmarrje të përbashkët nga Qeveria qendrore dhe NJVV-të. Përmes trajnime të Qendrës (Akademisë), e cila do të mbështet dhe nga donatorët, parashikohet që për periudhën 2026-2028 Qendra të trajnojë dhe të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë specifike dhe sektoriale të rreth 60% të zyrtarëve (punonjës dhe të zgjedhur vendorë) të NJVV-ve, me një kosto totale rreth 2,709,000 Euro në tre vite. Kjo kosto përfshin koston fillestare të ngritjes së Qendrës (14% të koston), koston e operimit të Qendrës (34%) dhe koston e trajnimeve (52%) dhe aktivitetëve të menaxhimit të njohurive. Kosto fillestare e ngritjes së Qendrës (381,000 Euro) do të financohet nga Qeveria Qendrore (QQ), ndërsa pjesa tjetër e koston prej rreth 2,320,000 Euro në tre vite do të financohet 50% nga QQ dhe 50% nga NJVV-të. Në këtë kuadër, cdo NJVV do të parashikojë në buxhetin afatmesëm për vitet 2026-2028, pjesën e saj të koston për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë, shërbime këto që do të ofrohen nga Qendra. Alokimi i këtij buxheti për trajnimin e punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë do të bëhet edhe në reference të Udhëzimit të MinFin nr. 8 datë 28.02.2025 - Për përgatitjen e PBA-së Vendore 2026-2028 dhe paraqitjen e tij në formatet përkatëse të shtojcave të këtij udhëzimi. Sipas shtojcës 4 të këtij udhëzimi produkti "nëpunës i trajnuar" i përket programit buxhetor me kod AA141 "Menaxhim dhe Shërbimet Mbështetëse" dhe përfshin sipas përshkrimit "Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë NJVV apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.). Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambjente trajnimi, pagesa për trajnuesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj". Shpenzimet për vitet 2026-2028 janë përllogaritur bazuar në koston për një të trajnuar, pjesa 50% të bashkëfinancimi nga NJVV-të, prej 56 euro (v.2025); 43 euro (v.2026) dhe 40 euro (v.2027 dhe v.2028), dhe përfshijnë kryesisht koston operacionale të Qendrës që mundësojnë ofrimin e shërbimeve të Qendrës (koston e personelit, të bordit dhe koston e tjera operative); koston e përgatitjes së trajnimeve (koston e përgatitjes dhe rishikimit të moduleve të trajnimit); koston e dhënjes së trajnimeve në nivel qarku (koston e materialeve për pjesëmarrësit, koston e trajnerëve dhe stafit mbështetës, koston e qerave të sallave për trajnim, koston kafe & bufe për pjesëmarrësit në trajtime) si dhe një fond rezerve prej 15%. Bazuar në koston për të trajnuar si më sipër, buxheti i trajnimeve për vitin 2026-2027-2028 për Bashkinë Shkoder parashikohet si në vijim.											
ii. Synimi i projektit											
Të garantohet financimi i kuotës së Akademisë së Pushtetit Vendor nga Bashkia dhe Qeveria Qendrore në mënyrë që të sigurohen në mënyrë më të qëndrueshme trajnimet e detyrueshme, zhvillimit profesional dhe platformave për shkëmbimin e njohurive mes stafeve dhe të zgjedhurve vendorë, për të rritur performancën e qeverisjes vendore.											
iii. Aktivitetet kryesore të projektit											
Realizimi i pagesës së kuotës për financimin e Akademisë së Pushtetit Vendor për trajnimin e punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë të Bashkisë											
b) Rezultatet që prisni											
Pagesa në mënyrë korrekte dhe në kohë e kuotës.											
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt							
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - Këshilli Bashkiak - Kabineti - Drejtoria e Financës				Bashkia e Shkodrës							
e) Shpenzimet e llogaritura											
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijëlekë)	Nga kjo: <table border="1"> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurime</td> <td>Operative</td> <td>Transferi me</td> <td>Kapitale</td> </tr> </table>				Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale							

A.1	Pagesë kuota së Akademisë së Pushtetit Vendor	1,037				1,037	
	Shuma	1,037				1,037	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pagesë kuota së Akademisë së Pushtetit Vendor	1,161				1,161	
	Shuma	1,161				1,161	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pagesë kuota së Akademisë së Pushtetit Vendor	1,161				1,161	
	Shuma	1,161				1,161	
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 – Dhjetor 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 5	PAA141.Q1.O1.A5. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Në zbatim të nenit 38 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, një nga burimet e financimit të qarkut janë nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak. Bashkia Shkodër është anëtare e Këshillit të Qarkut Shkodër, së bashku me Bashkinë Malësi e Madhe, Bashkinë Vau Dejës, Bashkinë Pukë dhe Bashkinë Fushë Arrëz. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë. Të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore. Kuotat e miratuara nga këshilli i qarkut bëhen pjesë e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore. Mes njësive të qeverisjes vendore dhe këshillit të qarkut mbahet një akt-marrëveshje për detyrimin vjetor ndaj këshillit të qarkut. Mbi bazën e titullit për arkëtim që lëshon këshilli i qarkut bëhet transferim i brendshëm nga njësi vendore në favor të këshillit të qarkut nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin në sistemin informatik financiar të qeverisë.						
ii. Synimi i projektit						
Përmbushja e detyrimit në bazë të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" .i ndryshuar						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Realizimi i pagesës së kuotës së anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut.						
b) Rezultatet që prisni						
Pagesa në mënyrë korrekte dhe në kohë e kuotës.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - Drejtoria e Financës			Bashkia e Shkodrës Këshilli i Qarkut Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pagesë kuota e anëtarësisë për Këshillin e Qarkut Shkodër	1,000				1,000
	Shuma	1,000				1,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pagesë kuota e anëtarësisë për Këshillin e Qarkut Shkodër	100				100
	Shuma	100				100
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pagesë kuota e anëtarësisë për Këshillin e Qarkut Shkodër	100				100
	Shuma	100				100
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar 2026 – Dhjetor 2028		Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.6	PAA141.Q1.O1.A6. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja .	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Ky aktivitet ka si synim që në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, të vendosë dhe nxitë bashkëpunimet midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe. Në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë kemi synim arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Gjithashtu për rritjen e harmonisë fetare në qytetin e Shkodrës çdo vit shtrohet lftar për komunitetin mysliman dhe qytetarët e Shkodrës me rastin e Muajit të Madhërishëm të Ramazanit.						
ii. Synimi i projektit						
Të garantohet standarti i shërbimeve të pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Përgatitja dhe organizimi i programit për vizitat e delegacionit të huaj dhe vendas dhe përfaqësimit të institucionit tonë në vizita apo ftesa për punë jashtë vendit. Përgatitja e preventivit dhe dokumentacioneve për ofrimin e shërbimit 2. Ofrimi i shërbimit 2.1 Organizimi i pritje- përcjellje të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja. 2.2 Organizim i darkes për lftar për komunitetin mysliman . 3. Monitorimi i procesit						
b) Rezultatet e pritshme						
Garantim i standartit të shërbimeve të pritje- përcjelljeve						
c) Aktoret e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
1. Kabineti 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 3. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër			Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet per çdo aktivitet 2026		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga & Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Shpenzime për ceremonialin zyrtar	1,500		1,500		
Shuma		1,500		1,500		
Shpenzimet per çdo aktivitet 2027		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga & Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Shpenzime për ceremonialin zyrtar	1,500		1,500		
Shuma		1,500		1,500		
Shpenzimet per çdo aktivitet 2028		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga & Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Shpenzime për ceremonialin zyrtar	1,500		1,500		
Shuma		1,500		1,500		
f) Periudha e zbatimit:		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë vitit 2026, 2027, 2028		1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Kabineti Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 7	PAA141.Q2.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak) shpenzime korente dhe kapitale	Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Këshilli Bashkiak përbëhet nga 51 këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Këshilli Bashkiak ka disa detyra dhe kompetenca: a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet; b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata; c) emëron dhe shkarkon sekretarin e Këshillit Bashkiak; ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues; - dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të Bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë; e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; f) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të Bashkisë; g) vendos për taksat e tarifave vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi; h) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve; - gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë; i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet; j) zgjedh përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar; j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji; k) miraton norma e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj l) vendos për simbolet e Bashkisë; - ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë; m) jep tituj nderi dhe stimuj; n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të Bashkia. . Për mbështetjen e funksionimit të organeve të zgjedhura vendore ku përfshihen Këshilli i Bashkisë Shkodër me 51 anëtarë, zbatohet VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit të Bashkisë Shkodër. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit kryhet në formën e shpërblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Për mbulimin e shpenzimeve të këshilltarëve bashkiakë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre si këshilltarë, për trajtim financiar për shërbim jashtë dhe Brenda vendit, Këshilli do të miratojë me vendim mënyrën se si do të veprohet. Të gjitha shpenzimet për funksionimin, mbarëvajtjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak që nuk janë të përfshira në këtë fishe projekti mbulohen buxheti i Bashkisë. Plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkia është bashkangjitur me këtë fishe projekt		
ii. Synimi i projektit		
• Mbështetja e funksionimit të Këshillit i Bashkisë Shkodër • Sigurimi i mbështetjes me shërbime operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak sipas aktiviteteve • Garantimi i masës së shpërblimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi. • Përmirësimi i kanaleve të komunikimit me qytetarët, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë matja punës dhe kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak. • Sigurimi i mbështetjes me shërbime operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak për aktivitetet: ○ Dërgim me postë të dokumenteve, shkresave të këshillit dhe këshilltareve ○ Kancelari ○ Transport ○ Shpenzime catering /coffee break ○ Shpenzime pritje percejllje • Realizimi i shpërblimit mujor për anëtarët e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër sistematikisht dhe me korrektësi për çdo muaj.		
b) Rezultatet që prisni		

- Funksionimi sipas ligjit i Bashkise Shkoder si rezultat i miratimit ne kohe te te gjitha akteve te paraqitura ne mbledhjet e Këshillit Bashkiak.
- Miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave/ Ardhurave dhe shpenzimeve
- Komuniteti i informuar si rezultat i transparences dhe llogaridhenies per veprimtarinë së Këshillit Bashkiak/
- Keshilli Bashkiak aktiv dhe pjesëmarrjes në aktivitete te rendesishme vendore, konferenca, dhe aktivitete me interes për KB
- Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve i miratuar.
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel te shqyrtuara dhe te miratuara
- Shërbimit i Pastrimit / Transportit / Ndrimit / Shërbimeve sociale / Arsimit baze dhe parashkollor/ Investimeve publike te monitoruara dhe te permiresuara;
- Ndërmarrja Ujësjellës/Kanalizime te analizuar/monitoruar.
- Aftesite e Sekretariatit e KB dhe keshilltareve te rritura dhe te permiresuara.
- Komuniteti dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit te permiresuara-Procedurat e Ankesave, Kerkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare te promovuara.
- Forumi e Shoqerise Civile dhe Rinise i informuar per punen e keshillit; Promovimi i Peticioneve dhe Iniciativave qytetare kryer.
- Komuniteti i konsultuar per Sherbimet e pastrimit, per Sherbimin te Pastrimit, te transportit , Ndrimit, te Shërbimeve sociale, te Arsimit baze dhe parashkollor.
- Buxheti vjetor dhe PBA te miratuar/ Paketa fiskale e miratuar/ Prioriteve e investimeve ne bashki te miratuar.
- Komuniteti i Bashkise Shkoder i mireinformuar per buxhetin e Bashkise dhe aktivitetin e Keshillit Bashkiak ne media vendore dhe online.
- Përmirësim i komunikimit me qytetarë, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe matja e performances së kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak.

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
• Komisioni i financave, buxhetit, dhe aseteve publike • Sekretari i Keshillit Bashkiak • Të gjitha drejtoritë e Bashkisë • Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse • Drejtoria e Financës • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia e Shkodrës

e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërblim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	75					75
A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percjellje)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			600		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
Shuma		20,331			20,241		90
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërblim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	75					75



A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percjellje)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			600		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
	Shuma	20,331			20,241		90
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërbllim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	75					75
A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percjellje)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			600		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
	Shuma	20,331			20,241		90
f) Periudha e zbatimit Janar 2026– Dhjetor 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Plani i punës dhe aktiviteteve - Këshilli Bashkiak Shkodër 2026	
Muaji	Përshkrimi i Aktivitetit
Janar	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve te Perhershme te Keshillit Bashkiak
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivitete të ngjashme
Shkurt	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve te Perhershme te Keshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin per ceshtje qe sipas ligjit kane nevoje per konsultim, norma e standarte te sherbimeve publike dhe fukioneve te tjera ligjore (ne varesi te projektvendimeve te paraqitura ne Këshill nga Bashkia)
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivitete të ngjashme
Mars	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përherhme të Këshillit Bashkiak
	Hartimi i raportit të veprimtarisë vjetore të Këshillit

	Hartimi dhe prezantimi i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 20)
Prill	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA, ndryshim buxheti, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore. (ne varesi të projektvendimeve të paraqitura në keshill nga Bashkia)
Maj	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Ceremoni dhenie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Pritje e delegacionit nga keshilla homologe
Qershor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Vizite studimore
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
Korrik	Mbledhje e Këshillit - (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Emision në median vendore dhe online
	Perfaqësim institucional i Këshillit: (në Shoqatat perkatese)
	Rishikim i Buxhetit vjetor
Gusht	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, (në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia)
Shtator	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia)
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: buxheti apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshim, (nr. 5 gjithsej i konsultimeve: nr. 4 i konsultimeve në NJA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Draftimi i planit vjetor i vendimmarrjes së Këshillit
	Draftimi i planit të trajnimit për këshilltarët
	Hartimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin
Tetor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: buxheti apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshim, (nr. 5 gjithsej i konsultimeve: nr. 4 i konsultimeve në NJA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Ceremoni dhenie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Pritje e delegacionit nga keshilla homologe
	Perfaqësim institucional i Këshillit në Shoqata, Këshill Konsultativ, etj. Diskutime për rolin e keshillit bashkiak në institucionet e perfaqësimit
Nëntor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (nr. 1 gjithsej i konsultimeve: nr.1 i konsultimeve me grupe interesi - në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia)
	Ceremoni dhënie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
Dhjetor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisionëve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Emision në median vendore dhe online

Nr. 8		PAA141.Q3.O1.A1.		Programi AA141: Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.	
Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës					
Përshkrimi i shkurtër i projektit:					
i. Situata					
